



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT	
AGJENCIA PROTIV KORUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	Nr. Prot.
Dep. <u>2-D/DPK</u>	Br. Prot. <u>01-2909/14</u>
Dep. <u>02</u>	Prot No. <u>18-08-2014</u>
Nr. I faq	Data
Broj stranica	Datum
Nr. pages	Date
	<u>18-08-2014</u>
PRISHTINE	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 15.08.2014, mori:

**V E N D I M**

**I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-2171/14, qe për trajtim ka pas zyrtarin e lartë z. Blerim Nikqi, Këshilltar komunal në Kuvendin Komunal të Pejës, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-03-2171/14, qe për trajtim ka pas zyrtarin e lartë z. Blerim Nikqi, Këshilltar komunal në Kuvendin Komunal të Pejës Gjatë zhvillimit të procedurës dhe analizimit të gjendjes është konstatuar se zyrtari i lartë, gjatë kohës së ushtrimit të funksionit publik si, Këshilltar komunal në Kuvendin Komunal të Pejës është duke ushtruar edhe funksion në veprimtari private, pra si person i autorizuar në një biznes privat, e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L-051, kjo situatë paraqet konflikt të mundshëm të interesit, dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit me datën 16.07.2014. e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë njoftuese se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet qe posedon Agjencia.

Pas këtyre procedurave, z. Blerim Nikqi, Këshilltar komunal në Kuvendin Komunal të Pejës, pasi ka kontaktuar me zyrtarët e Agjencisë ka kërkuar qe ti bëhet një sqarim lidhur me situatën e dyshuar për konflikt të mundshëm të interesit.

Zyrtarët e Agjencisë në takimin që është mbajtur me z. Nikqi, me datën 25.07.2014 e kanë njoftuar me faktet që posedon Agjencia, lidhur me konfliktin e mundshëm të interesit në ushtrim të funksionit publik, ndërsa z. Nikqi është pajtuar me gjendjen dhe është zotuar se në afat sa me të shpejt do të tërhiqet nga personi i autorizuar në kompaninë private dhe do bëjë ndryshimet e nevojshme dhe do të shmanget nga çfarë do situatë e mundshme e konfliktit të interesit.

Me datën 07.08.2014, z. Blerim Nikqi, ka sjell në Agjenci dokumentin zyrtar të lëshuar nga ARBK-ja ku dëshmohet se janë bërë ndryshimet e kërkuara dhe se në biznesin privat me nr biznesi 70142364 dhe emër "Elkos" sh.p.k- zyrtari në fjalë nuk është me si person i autorizuar në këtë kompani pasi që bordi i drejtoreve i kësaj kompanie me datën 29.07.2014, ka vendosur që të ndryshohet statuti i kësaj kompanie, duke ndryshuar numrin e personave të autorizuar dhe përgjegjës në këtë kompani.

Vlerësojmë se zyrtari i lartë publik me largimin e tij nga funksioni i personit të autorizuar në kompaninë private "Elkos" sh.p.k- dhe pas kërkesës së AKK-se, zyrtari ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej:

Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit,

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues)

Hasan Preteni  
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

